

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 14 KORRIK 2022

Është e disata herë që ju, ndjesë, por po abuzoni me pozicionin tuaj, si përfaqësuese e Konferencës së Kryetarëve! Sapo thatë se është vendosur në Konferencën e Kryetarëve që rezoluta për gjenocidin serb në Kosovë do të kalojë në Komisionin për Politikën e Jashtme. Kur u vendos? Kush e vendosi? Unë jam anëtar i Konferencës dhe kjo çështje nuk është diskutuar dhe nuk është vendosur. Nuk ka se si të vendoset, sepse kjo Rregullore i ka të qartë hapat proceduralë: paraqitet, brenda 3 ditëve mbledhet Konferenca e Kryetarëve, jo për ta diskutuar, jo për ta përcjellë në Komisionin për Politikën e Jashtme, por thjesht për të përcaktuar ditën dhe datën se kur do të duhet të debatohet në seancë, edhe kohën eventuale.

Madje Rregullorja përcakton edhe faktin tjetër, që së paku duhej të ishte një datë eventuale e përcaktuar nga ju brenda një muaji, brenda 27 qershorit. Tani po vjen 27 korriku, zonjë, jo vetëm që jeni një muaj e kusur në shkelje të procedurës, por po thoni diçka që nuk është e vërtetë. E pra, zonjë, ka edhe një seancë, sipas kalendarit të punimeve të këtij sesioni, që do të duhet domosdoshmërisht jo vetëm për të korrigjuar gabimet e bëra deri tani nga ju, si drejtuese e këtij Kuvendi, por, mbi të gjitha, për të bërë nderin e duhur lidhur me atë që është një detyrim moral që ka ky Kuvend, të debatojë për një nga çështjet më të rëndësishme që i përket gjysmës së kombit. Kaluam radhën e kaluar gjenocidin serb në Srebrenicë dhe nuk kalojmë gjenocidin serb në Kosovë. Kushdo që e dëgjon këtë fillon e krijon një pikëpyetje të madhe për moralitetin e këtij parlamenti. Ju merrni përsipër të thoni gjëra që nuk kanë ndodhur kurrë.

Një orë e më parë duhet të bëni këtë gjë: në seancën tjetër, të fundit të këtij sesioni, domosdoshmërisht duhet të jetë projektrezoluta jonë, por edhe projektrezoluta tjetër. Po, biem dakord apo jo, është tjetër gjë. Debatojmë? Po, edhe do të debatojmë. Do të flasim dhe do të japim vullnetin, vlerësimin dhe gjykimin tonë për atë çështje. Nuk ka rrugë tjetër. Është mundësia juaj e fundit për të korrigjuar këtë gabim, të cilin po e quaj pa faj deri tani, por me sa duket, nuk është i tillë. Faleminderit!